



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 14 prot.

Kamëz, më 22.8.2024

V E N D I M

Nr. 83. Datë 22/8 2024

MBI

**“EMËRTIMIN E NJË SHKOLLE 9-VJECARE, KOPSHTI DHE ÇERDDHES NË
TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.08.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.65 dhe 67 datë 20.08.2024 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 43 i VKB. 33 date 21.03.2024 “Për Miratimin e Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të një grupi të anëtarëve të Këshillit Bashkiak: **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Emërtimin **“Murat Toptani”**, shkollës 9-vjeçare sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Emërtimin **“Univers”**, kopshtit Nr.21 dhe të çerdhes Nr.7 sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

